



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Korçë, më datë 05/12/2023

Proces-verbal

Proces-verbal i mbajtur sot më datë 20 nëntor, ora 12:00 në kuadër të takimeve që Bashkia Korçë organizon me grupet e interesit për diskutimet për Paketën Fiskale të vitit 2024.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin Kletjon Kita Zv. Kryetar Bashkia Korçë, Soniel Prifti Drejtori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Korçë, dhe përfaqësues të biznesit të vogël.

Gjatë këtij takimi u vu në dukje:

- Bashkëpunimi i ndërsjellë që Biznesi i Vogël i Shqipërisë ka pasur me Bashkinë Korçë, kryesisht me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.
- Arritjet për formalizimin e biznesit në Bashkinë Korçë.
- Ofrimi i shërbimeve në kohë dhe me cilësi për t'u shërbyer sa më mirë banorëve të Bashkisë Korçë.
- Prezantimi i tarifave vendore të cilat do të ndryshohen dhe do të pësojnë një rritje, në tarifën e ndriçimit dhe gjelbërimit.
- U diskutua gjithashtu që bizneset të bëjnë një ditë gjatë javës pushim.

Për bizneset e vogla propozohet një rritje e tarifës së ndriçimit në masë nga 1 500 deri në 2 000 lek të vjetra në vit, në varësi të xhiros dhe të llojit të aktivitetit të biznesit. E njëjta gjë edhe për tarifën e gjelbërimit. Në fokusin e Bashkisë Korçë do të vijojnë të jenë bizneset e reja. Lehtësi do t'u jepet bizneseve të artizanatit, si edhe investitorëve të huaj të cilët do të zhvillojnë aktivitetin e tyre në Korçë. Lehtësi do të ketë edhe për organizatat jofitimprurëse të cilat do të zhvillojnë aktivitetin për herë të parë në Bashkinë Korçë.

Përfaqësuesit e Biznesit të Vogël listuan kërkesat e tyre si në vijim:

- Minimizimi i kontrolleve nga inspektorët e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, policia bashkiake si edhe minimizimi i masave administrative të marra nga institucioni i bashkisë.
- Pastrim më të shpeshtë të territorit dhe masa për ata që e ndotin ambientin.
- Të tregohet më shumë kujdes me qentë e rrugëve pasi përbëjnë rrezik për këmbësorët.

Proces-verbal i mbajtur sot më datë 21 nëntor, ora 11:00 në kuadër të takimeve që Bashkia Korçë organizon me grupet e interesit për diskutimet për Paketën Fiskale të vitit 2024.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin Kletion Kita Zv. Kryetar Bashkia Korçë, Soniel Prifti Drejtori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Korçë, Kryetari i Shoqatës së Biznesit të Vogël dhe të Mesëm të Shqipërisë z. Albert Nasto.

Gjatë këtij takimi u vu në dukje:

- Rritja e tarifës së ndriçimit dhe gjelbërimit për bizneset e vogla në masë nga 1 500 deri në 2 000 lek të vjetra në vit, në varësi të xhiros dhe të llojit të aktivitetit të biznesit. Rritja e tarifës së ndriçimit për biznesin e madh nga 3 000 lekë deri në 5 000 lek të reja në vit, në varësi të kategorisë së llojit të biznesit të madh dhe llojit të aktivitetit. Rritje e taksës së gjelbërimit nga 2000 deri ne 5000 lek te reja në vit.
- Bashkëpunimi i ndërsjelltë që Shqata e Biznesit të Vogël ka pasur me Bashkinë Korçë, kryesisht me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.
- U diskutua që një ditë gjatë javë të bëhet pushim.

Proces-verbal i mbajtur sot më datë 21 nëntor, ora 12:00 në kuadër të takimeve që Bashkia Korçë organizon me grupet e interesit për diskutimet për Paketën Fiskale të vitit 2024.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin Kletion Kita Zv. Kryetar Bashkia Korçë, Soniel Prifti Drejtori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Korçë, si edhe përfaqësuesit e biznesit të madh.

Gjatë këtij takimi u prezantua:

- Rritje e tarifës së ndriçimit nga 3 000 lekë deri në 5 000 lek të reja në vit, në varësi të kategorisë së llojit të biznesit të madh dhe llojit të aktivitetit. Rritje e taksës së gjelbërimit nga 2000 deri ne 5000 lek te reja në vit.
- U diskutua që të vendoset një ditë gjatë javës pushim për bizneset.

Konceptoi:

Specialiste L.Saro

Përgjegjëse

Larisa Katundi

Biznesi i Vogël



Kryetari i Shoqatës së Biznesit të Vogël dhe të Mesëm



Biznesi i Madh

